

**MARRËVESHJA MBI PARIMET E REKONSTRUIMIT TË TRUPIT KOORDINUES
PËR KOMUNAT PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË
SPORAZUM**

**O PRINCIPIA REKONSTRUKCIJE KOORDINACIONOG TELA ZA OPŠTINE
PREŠEVO, BUJANOVAC I MEDVEĐA**

Duke pasë parasysh „Planin dhe programin për zgjidhjen e krizës në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë“ i cili është hartuar 2001.

Të angazhuar me përkushtim të përhershëm ndaj qëllimit të këtij programi i cili e parashehë zhvillimin e shoqërisë multietnike dhe multikonfesionale, të bazuar në parimet demokratike, krahas respektimit të drejtave të njeriut, të drejtave politike dhe të drejtave të pakicave, si dhe të drejtat dhe liritë e të gjithë qytetarëve në pajtim me standardet më të larta,

Duke u bazuar në „Marrëveshjen mbi parimet themelore të mbajtjes së parakohëshme të zgjedhjeve komunale në jug të Serbisë“, e cila është nënshkruar më 18. mars 2002 në Beograd, Duke konsideruar se shoqëria pluraliste dhe e vërtetë demokratike duhet të krijojë kushtet përkatëse të cilat i mundësojnë të gjitha komuniteteve që të shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre,

Duke dëshmuar synimin e angazhimeve në formimin e qeverisjes multietnike në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës si dhe kyqjen përkatëse të komunitetit shqipëtarë në institucionet shtetërore, me ç’rast do të arrihej pjesëmarrja e tyre e drejtëpërdrejtë në procesin e vendimarrjes,

Nënshkruesit e kryejnë obligimin e vet i cili ka të bëjë me Vendimin mbi rregullimin dhe kompetencat e Trupit koordinues, e cila gjendet në shtojcën e kësaj Marrëveshje

Milan Marković
Ministër për administratë shtetërore dhe
vetëadministratë lokale
Kryetarë i Trupit Koordinues

Riza Halimi
Deputet popullorë në Kuvendin Popullorë
të Republikës së Serbisë

Ambasador Hans Ola Urstad
Kryeshef i Misionit të OSBES-së në Serbi

VENDIMI

PËR RREGULLIMIN DHE KOMPETENCAT E TRUPIT KOORDINUES

Kryesia e Trupit Koordinues në përbërjen e ngushtë dhe të zgjeruar.

- I. Në përbërjen e ngushtë e kryesisë së Trupit Koordinues bëjnë pjesë:**
- a. Kryetari i Trupit Koordinues
 - b. Kryetarët e Komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Kryetarët e komunave të Bujanocit dhe Preshevës në mënyrë alternative kryejnë edhe detyrën e zëvendëskryetarit të Trupit Koordinues .
 - c. Nënkryetarët e Trupit Koordinues të cilët emërohen nga Qeveria e Republikës së Serbisë
 - d. Deputetët popullorë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja.
 - e. Kryetarët e Kuvendeve të komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.
 - f. Drejtori i Shërbimit të Trupit Koordinues.
- II. Përbërjen e zgjeruar të kryesisë së Trupit Koordinues e përbëjnë:**
- a. Përbërja e ngushtë e Trupit Koordinues.
 - b. Kryetarët e 6 grupeve punuese (nga radha e ministrive).
 - c. Zëvendësit e kryetarëve të grupeve punuese (nga radhët e vetëqeverisjes lokale)
 - d. Zëvendësit e kryetarëve të komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës
 - e. Zëvendësit e kryetarëve të kuvendeve komunale të komunave të Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës.
- III. Vendimet në përbërjen e ngushtë dhe të zgjeruar të Kryesisë së Trupit koordinues bihen me konsensus**
- III. Grupet punuese:**
- a. ***Në përbërjen Trupin Koordinues janë këto grupe punuese:***
 1. *Për zhvillim ekonomik dhe të infrastrukturës,*
 2. *Për integrime politike dhe shoqërore,*
 3. *Për siguri dhe drejtësi,*
 4. *Për zhvillimin e kapaciteteve të qeverisjes lokale si dhe aftësimi i tyre për vetëzhvillim,*
 5. *Për arsim, kulturë, informim, sport dhe rini,*
 6. *Për shëndetësi dhe politikë sociale*
 - b. ***Grupet punuese kanë 12 anëtarë.***
 1. *Tre anëtarë të grupit punues janë nga radhët e ministrisë,*
 2. *Nga tre anëtarë të grupit punues janë nga radhët e pushtetit lokal të komunës së Preshevës, Bjanocit dhe Medvegjës.*
 - c. **Struktura e anëtarëve të propozuar të grupeve punuese duhet të jetë në proporcion me strukturën e grupeve etnike që jetojnë në atë komunë.**

V. KOMPETENCAT E TRUPIT KOORDINUES

- Kryetari i trupit koordinues e perfaqeson Trupin koordinues, udheheq me punen e tij dhe punon per bashkerendimin e organeve kompetente shtetore ne realizimin e obligimeve te tyre te cilat dalin nga Programi dhe vendimet e Trupit koordinues
- Zevendesi i kryetarit te Trupit koordinues e ndihmon dhe zevendeson kryetarin e Trupit Koordinues (ne rast te pamundesise se tij) dhe bashkerendon punen e vetadministratave lokale ne kryerjen e puneve te nevojshme per miratimin dhe realizimin e Programit dhe te vendimeve te Trupit koordinues
- Përbërja e ngushtë e kryesisë së Trupit Koordinues bënë planifikimin, programet operative, vendimet dhe rregulloren e Trupit Koordinues
- Përbërja e gjërë e kryesisë së Trupit Koordinues bënë strategjinë e punës së Trupit Koordinues si dhe përcjell realizimin e sajë.
- Grupet Punuese përpilojnë propozim vendimet, planet dhe programet operative të Trupit Koordinues.
- Drejtori I Shërbimit të Trupit Koordinues kryen obligimet e tijë në bazë të ligjit mbi zyrtaret shtetëror (Neni 33.1).
-

- VI. Funksionimi i Trupit Koordinues nuk mund të ndikojë në ngushtimin e të drejtave dhe kompetencave të vetadministratave lokale të përcaktuara me Kushtetutë.
- VII. Trupi Koordinues pas harmonizimit të qëdrimeve rreth Vendimit mbi rregullimin dhe kompetencat e Trupit Koordinues, do të fillojë me hartimin e Rregullores së Trupit Koordinues.

Nënshkruar në Beograd, më 27. 03. 2009

Millan Markoviq
Ministër për administratë shtetërore dhe vetadministratë lokale
Kryetar i Trupit koordinues

Riza Halimi
Deputet popullor në Kuvendin popullor të Republikës së Serbisë

Nadër Sadiku
Kryetar i Komunës së Preshevës

Shaip Kamberi
Kryetar i Komunës së Bujanocit

Slobodan Drashković
Kryetar i Komunës së Medvegjës

Jonuz Musliu
Kryetar i Kuvendit Komunal Bujanocit

Nenad Gjurgjević
Drejtor i Shërbimit të Trupit Koordinues